SHKOLLA TEKNIKE GJERGJ CANCO

S4J Aftësi për Punë Skills for Jobs

ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2017-2025

Shkolla Teknike Elektrike “Gjergj Canco”

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

SHKOLLA TEKNIKE GJERGJ CANCO

S4J Aftësi për Punë Skills for Jobs

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2017-2025) 10
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025) 16
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2017-2025) 17
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2017-2025) 17
Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2017-2025) 24
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2017-2025) 25
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2017-2025) 26
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2017-2025) 27
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025) 29
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2017-2025) 31
Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025) 32
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2025) 33
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025) 34
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2017-2025) 35

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 10
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 11
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025) 11
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 12
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2017-2025) 13
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2017-2025) 13
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 14
Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2017-2025) 15
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2017-2025) 15
Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 18
Figura 11: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2017-2025) 19
Figura 12: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 20
Figura 13: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2017-2025) 21
Figura 14: Madhësia e kompanisë (2017-2025) 22
Figura 15: Lloji i kontratës (2017-2025) 22
Figura 16: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2017-2025) 23
Figura 17: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025) 25
Figura 18: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025) 27
Figura 19: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025) 28
Figura 20: Lloji i institucionit (2020-2025) 28
Figura 21: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025) 29

Figura 22: Papunësia ndër vite (2017-2025) 30
Figura 23: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025) 30
Figura 24: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2017-2025) 32
Figura 25: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2017-2025) 34

SHKOLLA TEKNIKE GJERGJ CANCO

S4J Aftësi për Punë Skills for Jobs

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3

Lista e figurave 3

Gjetjet kryesore 6

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 8

Të diplomuarit 2017-2025 10

Analiza e rezultateve 12

- Statusi i punësimit 12
- Lidhja e punës me fushën e arsimit 15
- Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 16
- Niveli i pagave 18
- Kushtet e punës 21
- Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 23
- Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 25
- Mënyrat e gjetjes së punës së parë 26
- Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 27
- Të diplomuarit pa punë 30
- Propozimet për përmirësim në shkollë 33
- Planet për të ardhmen 35

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i nëntë brezave të të diplomuarve të Shkollës Teknike Elektrike "Gjergj Canco", duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2017.

- Në vitin 2025, 70% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit ndërsa niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2025 është 16%. 66% e të diplomuarve të papunë të vitit 2025 ishin në kërkim të një pune.
- 66% e të diplomuarve në TIK ishin të punësuar dhe të vetëpunësuar një vit pas diplomimit, 18% ishin të papunë, 19% ishin studentë/kursantë dhe 17% të papunë. Ndërkohë, 75% e të diplomuarve në Elektroteknikë ishin të punësuar dhe të vetë-punësuar një vit pas diplomimit, 16% ishin të papunë, 9% ishin student/kursantë.
- 43% e të diplomuarve në vitin 2024 u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. 29% e të gjurmuarve pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit në vendin e punës "shumë/jashtëzakonisht shumë", ndërkohë që 46% i përdorin "aspak/pak".
- Për vitin 2025, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 23% më pak se 50,000 lekë, 13% paguhen 50,001 – 60, 000 lekë, 29% paguhen 60,001 – 80, 000 lekë, 11% paguhen 80,001 – 95,000 lekë, 11% paguhen me shumën 95,001 – 120,000 lekë dhe 13% paguhen më shumë se 120,001 lekë. Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve 25% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 21% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë deri në 50,000 lekë. Ndërkohë, 10% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 15% e të diplomuarve në TIK marrin 50,000- 80,000 lekë, 32% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 26% e të diplomuarve në TIK marrin 60,001 – 80,000 lekë. Nga ana tjetër 12% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 11% në TIK marrin një pagë, 80,001 -95,000 lekë, e njëjta përqindje është dhe për fashën e pagës 95,001 – 120,000 Lekë. Një pagë më të lartë se 120,001 lekë e marrin 8% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 17% e të diplomuarve në TIK.
- 74% e të diplomuarve në vitin 2025 kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit. 63% e të diplomuarve të vitit 2023, e kanë gjetur punën përmes njohjeve, lidhjeve familjare dhe miqve.
- 68% e të diplomuarve në vitin 2025, u shprehën se ndjehen "të sigurt" ose "shumë të sigurt" në punën aktuale. Ndërkohë të diplomuarit që janë shprehur "shumë të pasigurt" janë12% me një rritje prej 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (7%) dhe 7% njehen "të pasigurt" me një ulje me 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (6%).
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2025, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim "shumë/jashtëzakonisht shumë". Theksi këtë vit është tek nevoja për përmirësim e praktikës në biznes (66%), praktikës në shkollë (64%), bashkëpunimi me bizneset (63%) dhe bashkëpunimi me Zyrat e Punës (57%), këshillimi i karrierës (57%).
- 45% e të diplomuarve në vitin 2025 kanë dëshirë të hapin biznesin e tyre në dy vitet e ardhshme, me një rritje prej 8 pikësh përqindje nga mesatarja 2017-2024 (37%).
  Ndërkohë, 34% e të diplomuarve kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, me një ulje prej 2 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (36%).


Për më tepër 22% kanë dëshirë të jenë të punësuar dhe 14% të emigrojnë jashtë vendit, me një ulje 8 pikë përqindje nga mesatarja 2017-2024 (22%).

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, Shkolla Teknike Elektrike "Gjergj Canco", me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për Punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **nëntë brezave me të diplomuar** të Shkollës Teknike Elektrike "Gjergj Canco".

Të diplomuarit 2017-2025


Në vitin shkollor 2024-2025, në Shkollën Teknike Elektrike “Gjergj Canco”, u diplomuan 219 nxënës (shiko tabelën 1), 12 nxënës më shumë së në vitin 2023-2024. Nga të diplomuarit e vitit 2024-2025 u gjurmuan 214 nxënës ose 98% e të diplomuarve.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2017-2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2016-2017	201	121	60%
2017-2018	201	121	60%
2018-2019	241	176	73%
2019-2020	208	165	79%
2020-2021	187	158	85%
2021-2022	145	129	89%
2022-2023	147	119	81%
2023-2024	207	170	82%
2024-2025	**219**	**214**	**98%**

Vetëm 10 nga të gjurmuarit i përket gjinisë femërore dhe gjithë të tjerët janë të gjinisë mashkullore (N=204).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=214

Figura 2 paraqet shpërndarjen e të gjurmuarve sipas drejtimeve që ofron shkolla. Në vitin 2025, 44% (N=95) e të gjurmuarve i përkasin drejtimit Elektroteknikë dhe 56% (N=119) drejtimit TIK.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=214

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 92% e të diplomuarve të gjurmuar u përgjigjën se jetonin në Shqipëri dhe 8% jashtë vendit. Mesatarisht, përgjatë 2020-2025, 90% e të diplomuarve kanë jetuar në Shqipëri dhe 10% jashtë vendit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=165); **2021** (N=158); **2022** (N=129); **2023** (N=119), **2024** (N=170), **2025** (N=214),

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2024-2025), nga një total prej 214 të anketuarish 41% (N=87) ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 4), 11% (N=24) ishin të vetëpunësuar, 18% (N=38) ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë, 14% (N=30) ishin student/kursant. Ndërkohë, të papunë ishin 16% (N=35) e të anketuarve.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=214

Për vitin 2025, rezultatet tregojnë se 70% e të diplomuarve janë të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit (shiko figurën 5). Viti 2025 shënon një rritje të punësimit me 10 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (60%). Gjithashtu, duhet theksuar se numri i nxënësve të diplomuar ka ardhur në rritje të ndjeshme nga viti paraardhës (referohu tabelës 1). Mesatarja e punësimit për të nëntë brezat e gjurmuar është 61%. Ndërkohë, të papunë janë mesatarisht 2017-2025, 23% e të diplomuarve. Ndërkohë, studime të mëtejshme ndjekin mesatarisht 15% e të diplomuarve.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017** (N=121); **2018** (N=121); **2019** (N=176); **2020** (N=165); **2021** (N=158); **2022** (N=129); **2023** (N=119); **2024** (N=170), **2025** (N=214).

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2025, 41% e të diplomuarve të gjurmuar janë të punësuar dhe 11% janë të vetëpunësuar (shiko figurën 6). Mesatarisht, gjatë viteve 2017-2025, 40% e të diplomuarve kanë qenë të punësuar dhe 10% të vetëpunësuar. Këtë vit vihet re një rritje e të dhe e të vetpunësuarve.


Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017** (N=121); **2018** (N=121); **2019** (N=176); **2020** (N=165); **2021** (N=158); **2022** (N=129); **2023** (N=119), **2024** (N=170), **2025** (N=214).

Në figurën 7 jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 66% e të diplomuarve në TIK ishin të punësuar dhe të vetëpunësuar një vit pas diplomimit, 18% ishin të papunë, 19% ishin studentë/kursantë dhe 17% të papunë. Ndërkohë, 75% e të diplomuarve në Elektroteknikë ishin të punësuar dhe të vetë-punësuar një vit pas diplomimit, 16% ishin të papunë, 9% ishin student/kursantë.

Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: TIK** (N=119), **ET** (N=95)

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 43% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën pozitivisht. Mesatarisht, përgjatë viteve 2017-2025 44% e të diplomuarve kanë pohuar se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. Ndërkohë, 56% kanë pohuar që puna e tyre aktuale nuk lidhet me fushën e tyre të studimit.


Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017** (N=48); **2018** (N=45); **2019** (N=81); **2020** (N=85); **2021** (N=89); **2022** (N=74); **2023** (N=74), **2024** (N=92), **2025** (N=133).

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 9), vërehet se mesatarisht (2017-2025) 52% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 34% e të diplomuarve në TIK pohojnë lidhjen e punës me fushën e arsimit. Sikurse tregohet edhe nga figura 9, janë të diplomuarit në Elektroteknikë ata të cilët pohojnë një lidhje më të madhe mes fushës së arsimit dhe punës.

Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**: N_{ET}=16, N_{TIK}=17; **2018**: N_{ET}=27, N_{TIK}=22; **2019**: N_{ET}=40, N_{TIK}=23; **2020**: N_{ET}=75, N_{TIK}=27; **Baza 2021**: N_{ET}=68, N_{TIK}=35; **Baza 2022:** N_{ET}=52, N_{TIK}=33; **Baza 2023:** N_{ET}=52, N_{TIK}=3, **Baza 2024:** N_{ET}=50, N_{TIK}=30, **Baza 2025:** N_{ET}=61, N_{TIK}=72

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e vitit 2025, sikundër edhe të diplomuarit e viteve të mëparshme japin dy arsye kryesore: (i) pamundësia e gjetjes së një pune që lidhet me studimet (50%) dhe (ii) paga/kushtet më të mira të punës aktuale (34.3%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	60%	48%	50%	31%	50%	40%	57%	**50%**
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	13%	6%	2%	9%	8%	7%	2%	**2.9%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	0%	18%	2%	17%	4%	5%	6%	**4.3%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	27%	24%	40%	43%	31%	40%	28%	**34.3%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=30); **2019** (N=33); **2020** (N=42); **2021** (N=35); **2022** (N=52); **2023** (N=43), **2024** (N=54); **2025** (N=70);

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2025 tregojnë se njohuritë përdoren "shumë/jashtëzakonisht shumë" nga 29% e të gjurmuarve, me një rënie prej 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (30%). Ndërkohë, 46% e të diplomuarve pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në vendin e punës "aspak/pak", duke ruajtur të njëjtën pikë përqindje më pak se mesatarja 2017-2024 (46%).

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2017-2025)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2017	55%	7%	12%	10%	16%
2018	44%	14%	20%	10%	12%
2019	22%	18%	29%	14%	16%
2020	17%	24%	28%	16%	16%
2021	17%	25%	16%	21%	20%
2022	27%	13%	35%	10%	15%
2023	17%	30%	23%	15%	15%
2024	16%	24%	32%	11%	17%
2025	**23%**	**23%**	**25%**	**20%**	**9%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017** (N=58); **2018** (N=59); **2019** (N=112); **2020** (N=102); **2021** (N=103); **2022** (N=86); **2023** (N=84), **2024** (N=115), **2025** (N=149).

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 30% e të diplomuarve në vitin 2025 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Nga ana tjetër, 48% e vlerësojnë me "pak/aspak" lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Mesatarisht, 31% e të diplomuarve në vitet 2017-2025 e vlerësojnë lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve "shumë/jashtëzakonisht shumë" dhe 45% me "pak/aspak".

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2017-2025)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2017	57%	7%	12%	12%	12%
2018	47%	12%	20%	8%	12%
2019	26%	17%	21%	22%	13%
2020	21%	17%	30%	17%	16%
2021	16%	17%	29%	17%	21%
2022	28%	12%	27%	23%	10%
2023	26%	16%	28%	15%	15%
2024	24%	17%	25%	18%	15%
2025	**25%**	**23%**	**23%**	**20%**	**10%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017** (N=58); **2018** (N=59); **2019** (N=112); **2020** (N=102); **2021** (N=103); **2022** (N=86); **2023** (N=84), **2024** (N=115), **2025** (N=149).

Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2025 (shiko figurën 10), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 23% më pak se 50,000 lekë, 13% paguhen 50,001 – 60, 000 lekë, 29% paguhen 60,001 – 80, 000 lekë, 11% paguhen 80,001 – 95,000 lekë, 11% paguhen me shumën 95,001 – 120,000 lekë dhe 13% paguhen më shumë se 120,001 lekë.

Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** (N=125).

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 11) tregon se niveli i pagave për të diplomuarit e vitit 2025 ka vijuar trendin pozitiv të përmirësimit. Vihet re një rënie në kategorinë 35,001 - 50,000 lekë, ku në 2025 përqindja është në 23%, nga një mesatare më e lartë prej 27% në periudhën 2017-2024 – një reduktim me 4 pikë përqindje. Rritje e lehtë vërehet në kategorinë 50,001 – 65,000 lekë, ku 11% e të diplomuarve në 2025 paguhen në këtë interval, krahasuar me mesataren 12% të viteve 2017 – 2024. Një tendencë rritëse ka edhe në kategorinë 65,001 - 80,000 lekë, ku vlera për vitin 2025 është 27%, kundrejt 10% mesatare.

Rritja më e theksuar shfaqet përsëri te kategoria e pagave më të larta. 38% e të diplomuarve të vitit 2025 marrin më shumë se 80,000 lekë, duke shënuar një rritje të jashtëzakonshme prej 21 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017 - 2024 (17%).


Figura 11: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=53); **2018 (**N=59); **2019** (N=96); **2020** (N=102); **2021** (N=103); **2022** (N=85); **2023** (N=82), **2024** (N=115), **2025** (N=149).

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 12), vetëm 25% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 21% e të diplomuarve në TIK marrin një pagë deri në 50,000 lekë. Ndërkohë, 10% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 15% e të diplomuarve në TIK marrin 50,000- 80,000 lekë, 32% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 26% e të diplomuarve në TIK marrin 60,001 – 80,000 lekë. Nga ana tjetër 12% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 11% në TIK marrin një pagë, 80,001 -95,000 lekë, e njëjta përqindje është dhe për fashën e pagës 95,001 – 120,000 Lekë. Një pagë më të lartë se 120,001 lekë e marrin 8% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 17% e të diplomuarve në TIK.

Figura 12: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_{ET}=61; N_{TIK}=72

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të tetë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Mesatarisht, 85% e të diplomuarve (2017-2025) punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit (shiko figurën 13). Ndërkohë, mesatarisht 11% e të diplomuarve 2017-2025 punojnë me kohë të pjesshme. Me kohë të plotë por sezonale punojnë mesatarisht 4% e të diplomuarve.


Figura 13: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=48); **2018 (**N=45); **2019** (N=81); **2020** (N=85); **2021** (N=89); **2022** (N=74); **2023** (N=74), **2024** (N=92), **2025** (N=125).

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 14), në brezin e fundit të të gjurmuarve (2025) vërehet se 18% e të diplomuarve punojnë në kompani 1-4 punonjës me një rënie prej 7 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (25%); 21% punojnë në kompani me 5-9 punonjës me një ulje me 7 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2023 (28%); 26% e të diplomuarve punojnë në kompani me 10-49 me 3 pikë përqindje më shumë sa mesatarja e viteve 2017-2024 (23%); dhe 34% punojnë në kompani me më shumë se 50 punonjës me një rritje prej 11 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (23%).


Figura 14: Madhësia e kompanisë (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=48); **2018 (**N=45); **2019** (N=81); **2020** (N=85); **2021** (N=89); **2022** (N=75); **2023** (N=74), **2024** (N=92), **2025** (N=125).

Në vitin 2025, 73% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 15). Nga ku, 57% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 16% me afat të caktuar. Ndërkohë, 26% nuk kanë një kontratë dhe vetëm 2% po bëjnë praktikën.


Figura 15: Lloji i kontratës (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=48); **2018 (**N=45); **2019** (N=81); **2020** (N=85); **2021** (N=89); **2022** (N=75); **2023** (N=74), **2024** (N=92), **2025** (N=125).

Sipas rezultateve të gjurmimit të të nëntë brezave, mesatarisht 81% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 16). Ndërkohë, mesatarisht 12% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe vetëm 6% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet.

Figura 16: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=48); **2018 (**N=45); **2019** (N=81); **2020** (N=85); **2021** (N=89); **2022** (N=75); **2023** (N=74), **2024** (N=92), **2025** (N=125).

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 68% e të diplomuarve në vitin 2025 u shprehën se ndjehen "të sigurt" ose "shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Përkatësisht 39% e të diplomuarve në vitin 2025 janë shprehur se ndjehen "të sigurt", me një rritje prej 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (38%) dhe 29% janë shprehur se ndjehen "shumë të sigurt" me një rritje prej 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (25%). Ndërkaq, 12% e të diplomuarve ndjehen "shumë të pasigurt" me një rritje prej 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (7%) dhe 7% njehen "të pasigurt" me një ulje me 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (6%).

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 66% e të diplomuarve të gjurmuar në vitin 2025 janë shprehur se ndjeheshin të "kënaqur" ose "shumë të kënaqur" dhe vetëm 14% janë shprehur se ndjeheshin "shumë të pakënaqur" ose "të pakënaqur".

Sikundër e tregon edhe tabela 5, vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në punën aktuale.

Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2017-2025)


	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	0%	3%	8%	0%	4%	8%	12%	7%	**12%**
I/e pasigurt	22%	13%	17%	25%	8%	7%	6%	4%	**7%**
Neutral	19%	28%	4%	37%	19%	16%	22%	23%	**13%**
I/e sigurt	28%	41%	46%	35%	54%	34%	22%	36%	**39%**
Shumë i/e sigurt	31%	16%	25%	3%	15%	34%	37%	30%	**29%**
Shumë i/e pakënaqur	6%	0%	8%	2%	1%	3%	8%	5%	**10%**
I/e pakënaqur	19%	13%	8%	13%	12%	3%	6%	1%	**4%**
Neutral	19%	25%	4%	30%	21%	22%	16%	22%	**20%**
I/e kënaqur	25%	50%	54%	51%	52%	38%	35%	41%	**37%**
Shumë i/e kënaqur	31%	13%	25%	5%	14%	34%	35%	30%	**29%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=48); **2018 (**N=45); **2019** (N=81); **2020** (N=85); **2021** (N=89); **2022** (N=75); **2023** (N=74), **2024** (N=92), **2025** (N=125).

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 74% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit dhe 4% 1 muaj pas diplomimit, 11% e kanë gjetur punën 1 – 3 muaj pas diplomimit, 6% 3 – 6 muaj pas diplomimit, 3% 6 - 9 muaj pas diplomimit dhe 2% kanë arritur të gjejnë punë 9 – 12 muaj pas diplomimit.

Figura 17: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025)



***Shënim**: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** (N=125).*

Në një vështrim krahasues me brezat e mëparshëm të të diplomuarve (shiko tabelën 6), mesatarisht 60% e të diplomuarve gjatë viteve 2017-2024 kanë arritur të gjejnë një punë para diplomimit. Në këtë aspekt, për vitin 2025, kemi një rritje me 14 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (60%) të të diplomuarve të cilët e gjejnë punën para diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 2017-2024, 13% e të diplomuarve gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit duke shënuar një rënie me 9 pikë përqindje për të diplomuarit e vitit 2025. Ndërkohë, është rritur me 3 pikë përqindje numri i të diplomuarve të cilët gjejnë punë 1-3 muaj pas diplomimit (9% mesatarja 2017-2024, 11% në 2025). Gjithashtu është rritur me 5 pikë përqindje numri i të diplomuarve të cilët gjejnë punë 3-6 muaj pas diplomimit (3% në 2025, 8% mesatarja 2017-2024). Gjithashtu vihet re një rënie me 3 pikë përqindje nga mesatarja e 2017-2024 (5%) e të diplomuarve të cilët gjejnë punë 9-12 muaj pas diplomimit

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	**2023**	**2024**	**2025**
Para diplomimit	55%	61%	38%	55%	58%	64%	29%	67%	**74%**
1 muaj pas diplomimit	11%	14%	18%	16%	14%	17%	11%	8%	**4%**
1 - 3 muaj pas diplomimit	4%	11%	8%	16%	10%	7%	23%	12%	**11%**

3 - 6 muaj pas diplomimit	17%	5%	20%	7%	6%	2%	24%	2%	**6%**
6 - 9 muaj pas diplomimit	8%	5%	8%	2%	4%	7%	7%	8%	**3%**
9 - 12 muaj pas diplomimit	6%	4%	8%	4%	9%	2%	6%	3%	**2%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=48); **2018 (**N=45); **2019** (N=81); **2020** (N=85); **2021** (N=89); **2022** (N=75); **2023** (N=74), **2024** (N=92), **2025** (N=125).

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të shtatë brezat e gjurmuar, mënyra mbizotëruese e gjetjes së punës së parë është nga njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë. Përkatësisht, 63% e të diplomuarve gjatë vitit 2025, pohojnë se kanë gjetur punë nga njohjet personale, me një rënie prej 5 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (68%). Ndërkohë, 21% pohojnë se e kanë gjetur punën nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta me një rritje prej 6 pikësh përqindje nga mesatarja 2017-2024 (15%).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	19%	4%	9%	13%	16%	24%	19%	18%	**21%**
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	71%	73%	74%	71%	63%	63%	65%	64%	**63%**
Nga praktika profesionale në biznes	6%	0%	0%	6%	4%	4%	3%	9%	**6%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	2%	16%	9%	6%	10%	8%	7%	4%	**6%**
Nga mësuesit	0%	2%	4%	1%	3%	0%	1%	0%	**0%**
Nga Zyra e Punësimit	2%	0%	0%	0%	1%	0%	1%	0%	**2%**
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	0%	4%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Tjetër	0%	4%	1%	4%	2%	1%	4%	4%	**3%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=48); **2018 (**N=45); **2019** (N=81); **2020** (N=85); **2021** (N=89); **2022** (N=75); **2023** (N=74), **2024** (N=90), **2025** (N=125).

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2025, 22% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (rënie me 3 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024, 25%), 28% pohuan se i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (rritje me 2 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024, 26%). Gjithashtu, mbetet i lartë numri i atyre që pohojnë se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar në gjetjen e punës së parë. Kështu, në vitin 2024, 43% e të diplomuarve të gjurmuar

pohojnë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar. Megjithatë, në këtë aspekt kemi qëndrueshmëri në pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (43%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2017-2025)


	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	12%	10%	34%	27%	28%	34%	32%	27%	**22%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	14%	19%	30%	35%	31%	30%	19%	31%	**28%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	10%	8%	13%	15%	13%	15%	8%	10%	**10%**
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	76%	61%	36%	26%	35%	36%	40%	37%	**43%**
Tjetër	0%	3%	2%	8%	4%	3%	8%	6%	**7%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=58); **2018 (**N=59); **2019** (N=112); **2020** (N=102); **2021** (N=103); **2022** (N=86); **2023** (N=84), **2024** (N=115), **2025** (N=149).

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2025, 18% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë, me një rritje prej 4 pikë përqindje nga 2024. Ndërkohë, 14% e të diplomuarve të gjurmuar për vitin 202 shprehen se janë student/kursant.


Figura 18: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** (N=68)

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2025 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin 97%, vetëm 3% e të diplomuarve nuk e kan specifikuar duke zgjedhur opsionin tjetër.


Figura 19: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=28); **2018 (**N=25); **2019** (N=46); **2020** (N=44); **2021** (N=53); **2022** (N=42); **2023** (N=13), **2024** (N=46), **2025** (N=30).

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 37% studiojnë në institucione publike, me një rënie prej 16 pikësh përqindje nga mesatarja 2020-2024 (53%). Ndërkohë, për vitin 2025 63% studiojnë në institucione private me një rritje prej 16 pikësh përqindje nga mesatarja 2020-2024 (47%).


Figura 20: Lloji i institucionit (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=44); **2021** (N=53); **2022** (N=42); **2023** (N=13), **2024** (N=46), **2025** (N=30).

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 21), 80% e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 20% të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Nga viti 2020 deri në 2025 mesatarisht 74% e të gjurmuarve u shprehën se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 26% të cilët pohojnë se nuk lidhen.

Figura 21: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=44); **2021** (N=53); **2022** (N=42); **2023** (N=13), **2024** (N=46), **2025** (N=30).

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 63% e të diplomuarve në 2024 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (51% mesatarja e viteve 2017-2024); 23% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (31% mesatarja e viteve 2017-2024); dhe 7% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (13% mesatarja e viteve 2017-2024).

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	50%	40%	48%	50%	60%	55%	54%	50%	**63%**
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	43%	40%	38%	32%	25%	21%	23%	28%	**23%**
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	4%	16%	7%	18%	11%	19%	15%	15%	**7%**
Nuk po gjeja dot punë	0%	0%	7%	0%	0%	0%	8%	2%	**3%**


Tjetër	4%	4%	0%	0%	4%	5%	0%	4%	**3%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=28); **2018 (**N=25); **2019** (N=29); **2020** (N=44); **2021** (N=53); **2022** (N=42); **2023** (N=13), **2024** (N=46), **2025** (N=30).

Të diplomuarit pa punë

Në vitin 2025, 16% e të diplomuarve të gjurmuar janë të papunë një vit pas diplomimit (figura 22). Mesatarisht, gjatë 2017-2025, 23% e të diplomuarve kanë qenë të papunë. Në këtë kontekst, vërehet një rënie e papunësisë për vitin 2025 me 7 pikë përqindje.


Figura 22: Papunësia ndër vite (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=121); **2018 (**N=121); **2019** (N=176); **2020** (N=165); **2021** (N=158); **2022** (N=129); **2023** (N=119), **2024** (N=170), **2025** (N=35).

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 66% e të diplomuarve të papunë të vitit 2025 u përgjigjën që po kërkonin për punë. Ndërkaq, 34% e të diplomuarve të papunë u shprehën se nuk po kërkonin për punë.

Figura 23: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=41); **2021** (N=29); **2022** (N=24); **2023** (N=21), **2024** (N=31), **2025** (N=35).

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: (i) mungesa e eksperiencës në punë (33% në 2025, 28% mesatarja 2017-2024), (ii) mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura për të gjetur një punë (25% në vitin 2025, 20% mesatarja 2017-2024), (iii) oferta për punë e cila nuk lidhet me arsimin (33% në vitin 2025, 13% mesatarja 2017-2024).

Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	13%	12%	18%	24%	38%	40%	27%	52%	**33%**
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	8%	15%	6%	0%	4%	0%	0%	4%	**0%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	8%	9%	10%	9%	13%	13%	27%	12%	**33%**
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	10%	24%	16%	36%	13%	27%	27%	8%	**25%**
Nuk ka punë në qarkun tim	13%	26%	18%	15%	13%	7%	0%	8%	**8%**
Jam i/e angazhuar në punë familjare	23%	6%	0%	6%	0%	0%	0%	4%	**0%**
Nuk di si të kërkoj për punë	0%	0%	0%	0%	4%	0%	0%	4%	**0%**
Tjetër	28%	0%	14%	9%	17%	13%	20%	8%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=40); **2018 (**N=34); **2019** (N=50); **2020** (N=33); **2021** (N=24); **2022** (N=15); **2023** (N=15), **2024** (N=25), **2025** (N=12).

Më tej, të diplomuarit e papunë të cilët nuk ishin në kërkim të një pune u pyetën për arsyet e mos kërkimit të punës (shiko tabelën 11). 4 nga 12 (33%) e të diplomuarve të papunë të cilët nuk ishin në

kërkim të një punë pohuan se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin, 33% (N=4) po prisnin të fillonin punë së shpejti, 25% (N=3) kishte në plan të largohej nga vendi, 8% (N=1) kujdesej për fëmijët/familjen.


Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Po pres të filloj punë së shpejti	25%	40%	22%	17%	17%	**33%**
Nuk kam besim se do gjej një punë	13%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	13%	20%	67%	17%	33%	**33%**
Kam në plan të largohem nga vendi	50%	40%	11%	33%	17%	**25%**
Kujdesem për fëmijët/familjen	0%	0%	0%	17%	17%	**8%**
Jam me aftësi ndryshe	0%	0%	0%	17%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=8); **2021** (N=5); **2022** (N=9); **2023** (N=6), **2024** (N=6), **2025** (N=12).

Për vitin 2025, 49% (N=17) e të diplomuarve të papunë kanë qenë më herë në marrëdhënie pune. Ndërkohë, 51% (N=18) nuk kanë qenë më herët në marrëdhënie pune. Mesatarisht, 2017-2024, 33% e të diplomuarve te papunë kanë qenë më parë në marrëdhënie pune, dhe 67% nuk kanë qenë.

Figura 24: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=40); **2018 (**N=34); **2019** (N=49); **2020** (N=41); **2021** (N=29); **2022** (N=24); **2023** (N=21), **2024** (N=31), **2025** (N=35).

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë "shumë/jashtëzakonisht shumë" nevojë për përmirësim. Theksi këtë vit është tek nevoja për përmirësim e praktikës në biznes (66%), praktikës në shkollë (64%), bashkëpunimi me bizneset (63%) dhe bashkëpunimi me Zyrat e Punës (57%), këshillimi i karrierës (57%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2016-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Infrastruktura	64%	68%	40%	33%	46%	43%	38%	40%	**41%**
Kurrikula		32%	36%	37%	53%	50%	47%	46%	**44%**
Tekstet dhe materialet	55%	29%	47%	39%	57%	47%	49%	47%	**49%**
Metodat e mësimdhënies	38%	29%	44%	42%	56%	48%	56%	52%	**50%**
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve		41%	43%	35%	54%	46%	50%	50%	**50%**
Praktika në shkollë	81%	66%	63%	52%	67%	54%	62%	57%	**64%**
Praktika në biznes	83%	73%	60%	58%	72%	60%	60%	62%	**66%**
Këshillimi i karrierës	69%	46%	50%	47%	61%	55%	57%	48%	**57%**
Bashkëpunimi me bizneset		61%	63%	55%	67%	61%	58%	54%	**63%**
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	76%	56%	62%	54%	69%	57%	59%	51%	**57%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=58); **2018 (**N=59); **2019** (N=112); **2020** (N=165); **2021** (N=140); **2022** (N=129); **2023** (N=92), **2024** (N=144), **2025** (N=185).

Nëse do të kishin mundësi, 77% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë (shiko figurën 25), me një rritje prej 4 pikësh përqindje nga mesatarja 2018-2024 (73%). Ndërkohë, 75% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë, me një rritje me 4 pikë përqindjeje nga mesaatarja 2018-2024 (71%).

Figura 25: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=121); **2019** (N=176); **2020** (N=165); **2021** (N=158); **2022** (N=129); **2023** (N=119), **2024** (N=170), **2025** (N=214)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Për vitin 2025, 78% e të diplomuarve në Elektroteknikë do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 74% të njëjtën shkollë. Ndërkohë, 77% e të diplomuarve në TIK do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe po 77% të njëjtën shkollë. Mesatarisht 2018-2024, 734% e të diplomuarve në Elektroteknikë do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 70% të njëjtën shkollë. Ndërkohë të diplomuarit në TIK, mesatarisht për vitet 2018-2024, 75% do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe po 75% të njëjtën shkollë.

Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025)

		Elektroteknikë	TIK
2018	Degë	70%	91%
	Shkollë	64%	69%
2019	Degë	81%	81%
	Shkollë	77%	71%
2020	Degë	80%	77%
	Shkollë	74%	84%
2021	Degë	77%	68%
	Shkollë	75%	85%
2022	Degë	68%	67%
	Shkollë	63%	69%
2023	Degë	71%	65%
	Shkollë	68%	77%
	Degë	65%	77%

2024	Shkollë	72%	72%
2025	Degë	**78%**	**77%**
	Shkollë	**74%**	**77%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018**: N_{ET}=53, N_{TIK}=35; **Baza 2019**: N_{ET}=87, N_{TIK}=42; **Baza 2020**: N_{ET}=122, N_{TIK}=43; **Baza 2021**: N_{ET}=92, N_{TIK}=66; **Baza 2022:** N_{ET}=75, N_{TIK}=54; **Baza 2023:** N_{ET}=76, N_{TIK}=43, **Baza 2024:** N_{ET}=89, N_{TIK}=48, **Baza 2025:** N_{ET}=95, N_{TIK}=119.

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimeve të mëtejshme (shiko tabelën 14), 45% e të diplomuarve në vitin 2025 kanë dëshirë të hapin biznesin e tyre në dy vitet e ardhshme, me një rritje prej 8 pikësh përqindje nga mesatarja 2017-2024 (37%).

Ndërkohë, 34% e të diplomuarve kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, me një ulje prej 2 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (36%). Për më tepër 22% kanë dëshirë të jenë të punësuar dhe 14% të emigrojnë jashtë vendit, me një ulje 8 pikë përqindje nga mesatarja 2017-2024 (22%).

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të jem punësuar	10%	13%	23%	15%	15%	13%	15%	18%	**22%**
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	45%	36%	42%	41%	36%	28%	33%	28%	**34%**
Të kem filluar biznesin tim	13%	21%	34%	33%	44%	53%	54%	42%	**45%**
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	33%	24%	20%	19%	24%	19%	9%	13%	**23%**
Të kem emigruar jashtë vendit	21%	31%	26%	27%	25%	19%	13%	14%	**14%**
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	1%	1%	1%	1%	1%	2%	2%	1%	**1%**
Tjetër	4%	6%	4%	2%	1%	4%	5%	8%	**6%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=121); **2018 (**N=121); **2019** (N=176); **2020** (N=165); **2021** (N=158); **2022** (N=129); **2023** (N=119), **2024** (N=170), **2025** (N=214)

Përfundime dhe rekomandime për Njësinë e Zhvillimit

Gjurmimi i brezit 2024–2025 arriti mbulimin më të lartë ndër nëntë brezat (98%), ndaj ky brez është baza më e besueshme e shkollës për krahasimet në vijim. Punësimi u rrit në 70% (mesatarja 2017–2024: 60%) dhe tre të katërtat e të punësuarve e gjetën punën para diplomimit. Kjo ndodhi kryesisht përmes rrjetit familjar dhe shoqëror, ndërsa roli i shkollës mbetet shumë i kufizuar. Fushat që kërkojnë vëmendje janë lidhja me punëdhënësit, papunësia, përputhshmëria e punës me arsimin (sidomos në TIK) dhe kushtet e punës, veçanërisht mungesa e kontratës.

1. Gjurmimi si praktikë e përhershme
Mbulimi i arritur në 2025 të ruhet si standard i shkollës, dhe krahasimet me brezat e mëparshëm të lexohen si orientuese.
Gjetja: U gjurmuan 214 nga 219 të diplomuar (98%), kundrejt 170 nga 207 (82%) në 2024. Mbulimi në brezat 2017–2023 ka qenë 60–89%.

2. Roli i shkollës në lidhjen me punëdhënësit
Shkolla të ndërtojë një regjistër të punëdhënësve partnerë, të përforcojë bashkëpunimin me Zyrat e Punësimit dhe t'i përdorë bizneset e praktikës si kanal të drejtpërdrejtë punësimi.
Gjetja: 63% e të punësuarve (N=125) e gjetën punën e parë përmes njohjeve, familjes dhe miqve. Vetëm 6% e gjetën përmes praktikës në biznes, 2% përmes Zyrës së Punësimit, dhe asnjë përmes mësuesve apo qendrës së karrierës/Njësisë së Zhvillimit. 43% thonë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar në gjetjen e punës dhe vetëm 10% se i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës. Të diplomuarit e vlerësojnë si fusha me më shumë nevojë për përmirësim praktikën në biznes (66%), praktikën në shkollë (64%), bashkëpunimin me bizneset (63%) dhe këshillimin e karrierës e bashkëpunimin me Zyrat e Punësimit (secila 57%).

3. Ndjekja e të diplomuarve të papunë
Të diplomuarit e papunë të kontaktohen individualisht, t'u ofrohet referim në Zyrën e Punësimit dhe lidhje me punëdhënës, me përparësi për ata që po kërkojnë punë.
Gjetja: 35 të diplomuar (16%) janë të papunë një vit pas diplomimit, nga një mesatare prej 23% në nëntë vjet. 66% e tyre po kërkojnë punë dhe 34% (12 persona) jo. Mungesa e eksperiencës dhe ofertat që nuk lidhen me arsimin përmenden secila nga 33%, dhe mungesa e kontakteve nga 25%. Baza e arsyeve është shumë e vogël (N=12), ndaj ato duhen lexuar vetëm si orientim cilësor. 51% e të papunëve (N=18) nuk kanë pasur kurrë marrëdhënie pune.

4. Përputhshmëria e punës me arsimin, me fokus te drejtimi TIK
Programi dhe praktika e drejtimit TIK të rishikohen së bashku me bizneset e sektorit, me synim lidhjen më të mirë me vendet e punës.
Gjetja: Vetëm 43% e të punësuarve thonë se puna lidhet me fushën e studimit, dhe 50% e atyre që nuk punojnë në fushë thonë se nuk gjetën punë të përshtatshme. Mesatarisht 2017–2025, lidhja është 34% në TIK kundrejt 52% në Elektroteknikë. Në 2025, 66% e të diplomuarve në TIK (N=119) janë të punësuar, kundrejt 75% në Elektroteknikë (N=95). Vetëm 29% i përdorin njohuritë e shkollës "shumë/jashtëzakonisht shumë" dhe 46% "aspak/pak".

5. Kushtet e punës, të drejtat në punë dhe sipërmarrja
Në vitin e fundit të përfshihet një modul i shkurtër për kontratën e punës, sigurimet shoqërore dhe hapat për nisjen e një biznesi.
Gjetja: 26% e të punësuarve nuk kanë kontratë pune dhe 12% ndjehen "shumë të pasigurt" (mesatarja 2017–2024: 7%). Në mesataren e nëntë brezave, 12% thonë se punëdhënësi nuk u paguan sigurimet dhe 6% nuk kanë informacion. 45% planifikojnë të nisin biznesin e tyre brenda dy viteve (mesatarja 2017–2024: 37%).

6. Pjesëmarrja e vajzave dhe analiza sipas gjinisë
Shkolla të vendosë objektiva për rritjen e regjistrimit të vajzave, veçanërisht në TIK, dhe të ruajë regjistrimin sipas gjinisë në çdo gjurmim.
Gjetja: Vetëm 10 nga 214 të gjurmuarit (4.7%) janë femra. Me këtë bazë nuk mund të bëhet analizë e ndarë sipas gjinisë për punësimin, pagat apo kontratat.